

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK ELBASAN

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjiellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe "Bilancin e Ujit" në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqërie rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lart të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

"Bilanci i Ujit" si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet me të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjiellësve).

Duke pasur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave me Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga "lart-poshtë" (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Cërrik, UK Belsh dhe UK Peqin.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje për të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Elbasan jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, nuk konstatohen për asnjë njësi probleme të theksuara të nën faturimit me matje, megjithatë norma e konsumit të matur duhet të përmirësohet për ish shoqërinë UK Belsh (143.5l/ditë për banor) dhe Librazhd (133.9 l/ditë për banor) për të cilët ekziston mundësia e përdorimit prej tyre të ujit për ujitje. Probleme me faturimin aforfe konstatohen për të gjitha njësitë e Sh R Elbasan. Më problematik rezulton Njësia Belsh, e cila duhet të kryejë verifikimet e duhura mbi numrin e lidhjeve, si dhe të saktësojë volumet e faturuara, të cilat të krahasuara me të dhënat e katër viteve të fundit nuk përkojnë me të dhënat e raportuara për vitin 2022.

Në tërësi, të gjitha Njësitë duhet të fokusohen në verifikimin e numrit të lidhjeve me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për këtë lloj faturimi, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëria UK Peqin (171.7 litra/ditë për banor) duhet të analizojë të dhënat mbi volumet faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh. R Elbasan	Popullsia me shërbim	Konsumi Total (në m3)	Konsumi i Matur (në m3)	Konsumi i Pamatur (në m3)	Nr. Lidhjeve me Matës	Nr. Lidhjeve Pa matës	Konsumi (l/ditë, banor)		
							Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
Elbasan	89,078	3,740,000	2,714,000	1,026,000	27,699	8,424	108.9	135.3	115.0
Librazhd	11,175	545,147	539,447	5,700	4,700	57	133.9	116.6	133.7
Gramsh	19,085	609,800	585,800	24,000	4,986	192	87.3	92.9	87.5
Cërrik	15,009	666,000	557,000	109,000	6590	1,273	121.3	122.9	121.6
Belsh	13,677	659,500	657,600	1,900	6,447	578	143.5	4.6	132.1
Peqin	10,177	400,000	388,000	12,000	3,651	70	106.5	171.7	107.7
Shuma	158,201	6,620,447	5,441,847	1,178,600	54,073	10,594	112.7	124.6	114.7

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në **tabelën 2**, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. R Elbasan	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në Sistem (në m3)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia* e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij (në m3/vit)	Sasia e Disponuesh me e Ujit (l/ditë, banor)	
						Sasia e Disponuesh me e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
Elbasan	89,078	14,061,700	115.0	125,460	46,849,000	1,023	+908
Librazhd	11,175	545,147	133.7	25,000	1,576,800	173	+39
Cërrik	19,085	2,026,000	87.5	21,654	2,714,000	343	+256
Belsh	15,009	1,283,700	121.6	21,544	2,112,912	269	+147
Gramsh	13,677	1,150,000	132.1	18,657	3,253,000	478	+346
Peqin	10,177	1,952,000	107.7	22,536	6,186,750	752	+644
Sh. R. Elbasan	158,201	21,018,547	114.7	234,851	62,692,462	731	+617

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë për llogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se shoqëria rajonale UK Elbasan ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshëm, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitet përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit më ujë 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Elbasan

Gjatë vitit 2022, Njësia Elbasan ka prodhuar 14,061,700 m³ ujë i cili **vlërësohet 100%** pasi asnjë nga burimet nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.

Raportohen 40.060 lidhje uji ndërsa shërbimi për furnizimin me ujë ofrohet për rreth **71 %** të popullsisë në juridiksion.

“UPA” është në nivelin 69.60%.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë është pjesërisht i organizuar me zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të me problematike. Klientët të cilët faturohen me matje përbëjnë 78.4% të numrit total të lidhjeve.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Elbasan.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Elbasan- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	14,061,700	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,228,000	22.96%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,047,200	7.45%
Faturimi Total	4,275,200	30.40%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	51,851	0.37%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	703,085	5.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	2,727,603	19.40%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,114,244	15.04%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	5,544,932	39.43%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	840,617	5.98%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	184,292	1.31%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	190,000	1.35%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	2,952,957	21.00%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	21,851	0.16%
Humbjet Reale (Teknike)	4,189,717	29.80%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	9,734,649	69.23%
UJI PA TË ARDHURA	9,786,500	69.60%

Komente :

- UPA në nivelin 69.60% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele mjaft të larta dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar 100% i vlerësuar (pa matje) mund të sjellë pasaktësi të mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar, duke u bërë dhe shkaku kryesor i diferencës mjaft të madhe që ekziston ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar, si edhe treguesin UPA të pabesueshëm. Humbjet e ujit nga pasaktësia në matjen e ujit, nën faturim etj. rezultuan 15.4% e prodhimit.
- Humbjet Administrative prej 39.43% konsiderohen mjaft të larta. Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (5%) e të shpërndarjes (19.40%) rezultuan në nivele të larta për të cilat duhen marrë masa urgjente për zbulimin dhe minimizimin e tyre.
- Humbjet teknike, 29.80 % e prodhimit vjetor, duken në nivele të larta dhe shkaktohen kryesisht nga rrjedhjet e defektet në rrjetit të shpërndarjes.

Rekomandime:

- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*
- *Ti kushtohet kujdes vlerësimit të volumit të ujit të prodhuar, për t'ju afruar sa më shumë realitetit deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Për humbjet reale të larta në linjat e shpërndarjes, nëse janë probleme evidente të gjendjes së keqe fizike të tyre, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Gramsh

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Gramsh ofrohet për 88.1% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet 1,115,000 m³ ujë, **vetëm 3% e tij matet** pasi përgjithësisht burimet e shfrytëzueshme nuk janë të pajisur me matës.

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 5,877 lidhje ku 96.73% e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 61.13 % të prodhimit ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 38.87%.**

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 4 paraqiten komponent përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Gramsh.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Gramsh – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,150,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	679,000	59.04%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	24,000	2.09%
Faturimi Total	703,000	61.13%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	9,900	0.86%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	30,000	2.61%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	25,000	2.17%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	97,840	8.51%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	152,840	13.29%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	64,600	5.62%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	9,400	0.82%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	31,500	2.74%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	176,600	15.36%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	2,160	0.19%
Humbjet Reale (Teknike)	284,260	24.72%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	437,100	38.01%
UJI PA TË ARDHURA	447,000	38.87%

Komente :

- UPA konsiderohet në kufijtë e performancës së dobët (30-50%), me tendencë drejt kufirit të performancës së mirë.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (97% i vlerësuar), e bën të pabesueshme vlerën e treguesit të UPA.
- Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim rezultuan 8.51% e prodhimit.
- Humbjet administrative në nivelin 13.29 % të prodhimit, shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (2.61%) e të shpërndarjes (2.17%).
- Humbjet teknike në nivelin 24.72%, rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (15.36%) dhe atë të transmetimit (5.62%) dhe konsiderohen në kufijtë e niveleve të pranueshme, megjithatë shoqëria duhet të konsiderojë mundësinë e uljes së tyre.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj, për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*

- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Cërrik

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Cërrik ofrohet për 69.7% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet i vlerësuar në sasinë 2,026,000 m³ ujë dhe asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.

Nga raportimi i të dhënave, Faturimi Total rezulton 31.15% e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 68.85%.**

Ish shoqëria UK Cërrik ka në administrim 8,359 lidhje me ujin, ku 84.8 % e tyre faturohen me matje dhe pjesa tjetër aforfe.

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në baze të DMA-ve.

Në Tabelën 5 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Cërrik.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Cërrik – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	2,026,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	631,000	31.15%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	0	0.00%
Faturimi Total	631,000	31.15%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	8,000	0.39%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	179,400	8.85%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	303,900	15.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	202,080	9.97%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	685,380	33.83%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	115,000	5.68%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	60,000	2.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	60,780	3.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	435,840	21.51%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	30,000	1.48%
Humbjet Reale (Teknike)	701,620	34.63%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,387,000	68.46%
UJI PA TË ARDHURA	1,395,000	68.85%

Komente :

- Treguesi i UPA në vlerën **68.85 %** konsiderohet në nivele të larta e të pa pranueshme. Gjithsesi, vërtetësia e nivelit të UPA duhet verifikuar në terren nga prania e lidhjeve të

paligjshme në transmetim e shpërndarje, numri i lidhjeve me dhe pa matës, elementet e humbjeve teknike etj.

- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në zona të ndara me matje (DMA), formati i bilancit të ujit shpesh herë plotësohet me vështirësi, nevoja për trajnim të stafit teknik është e domosdoshme.
- Humbjet teknike në nivelin 34.63 % të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta, qe janë në rrjetin shpërndarës (21.51 %) dhe atë të transmetimit (5.68%).
- Konsumi total faturohet në nivelin 31.15 % është i papranueshëm sepse 84.8 % e konsumatorëve janë të pajisur me matësa individuale ndërsa tjetër faturohet aforfe.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100 %, që të bëjë të mundur minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e veprimeve për zvogëlimin e tyre.*

II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Belsh

Në Njësinë Administrative Belsh shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 73,3 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet në sasinë 1,283,700 m³ ujë, ***pra nuk ka matësa të instaluar në burim.***

Treguesi i UPA është në nivelin 37.95% .

Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin **62.05 %** ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 0.08% të prodhimit.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 7382 lidhje, nga të cilat rreth 92 % e tyre faturohet me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe.

Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme si në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit.

Treguesi UPA përfaqëson 37.95% të prodhimit vjetor.

Në Tabelën 6 paraqitet Bilanci i Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Belsh.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Belsh – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,283,700	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	794,900	61.92%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,690	0.13%
Faturimi Total	796,590	62.05%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	1,000	0.08%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	25,674	2.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	64,185	5.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	77,066	6.00%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	166,925	13.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	64,185	5.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	15,000	1.17%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	12,000	0.93%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	20,000	17.14%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	8,000	0.62%
Humbjet Reale (Teknike)	19,185	24.86%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	486,110	37.87%
UJI PA TË ARDHURA	487,110	37.95%

Komente :

- Treguesi i UPA (37.95 %) ndonëse pranë kufirit të performancës së mire ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.
- Vlerësimi i prodhimit në nivelin 100 % të tij, e bën të pabesueshëm vlerën e treguesit të UPA.
- Konsumi raportohet i matur në nivelin 99.78 % të konsumit total ndërkohë 92 % e klientëve faturohen me matje.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA).
- Humbjet e dukshme nga lidhjet e paligjshme në transmetim (2 %) dhe në shpërndarje (5 %) janë optimiste, por duken jo të besueshme dhe duhet të verifikohen në terren.
- Humbjet teknike (24.86 %) shkaktohen nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit (5 %) dhe atë të shpërndarjes (17.14 %), që gjithsesi duhen marrë masa për reduktimin e tyre.
- Stafi paraqet vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit.

Rekomandime:

- Duke pasur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, prandaj shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Duke pasur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.5 UPA për Ish Shoqërinë UK Peqin

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Peqin ofrohet për 45.2 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet 1,952,000 m³ ujë, por i vlerësuar (pa matje në burim). Numri i lidhjeve raportohet 3960 lidhje ku 98 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Faturimi Total rezulton në nivelin 27.53 % të prodhimit.

“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 72.47 %. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 7 jepen komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Peqin.

Tabela 7. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Peqin – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,952,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	529,330	27.12%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	8,100	0.41%
Faturimi Total	537,430	27.53%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	3,000	0.15%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	125,060	6.41%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	477,610	24.47%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	156,420	8.01%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	759,090	38.89%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	97,600	5.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	58,560	3.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	97,600	5.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	390,160	19.99%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	8,560	0.44%
Humbjet Reale (Teknike)	652,480	33.43%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	1,411,570	72.31%
UJI PA TË ARDHURA	1,414,570	72.47%

Komente :

- *Treguesi i UPA në vlerën prej 72.47 % rezulton në nivele të larta dhe të pa pranueshme.*
- *Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 100% i vlerësuar), mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.*
- *Humbjet administrative në nivelin 38.89 % të prodhimit, shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (6.41 %), shpërndarje (24.47 %) si dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim (8.01 %). Këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ për shoqërinë.*
- *Humbjet teknike në nivelin 33.43 %, rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (19.99 %), nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim (3 %), nga rrjedhjet në depo (5 %) etj. duke u konsideruar në kufijtë e niveleve të pa pranueshme. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për verifikimin dhe mundësinë e reduktimit të tyre.*

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të raportuar të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

II.6 UPA për Ish Shoqërinë UK Librazhd

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Librazhd ofrohet për 44,7 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor në sasinë 1,115,000 m³ ujë raportohet **i vlerësuar në nivelin 100 %**, asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës.

Faturimi Total përfaqëson 48.89 % e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” përbën 51.11 % e tij**. Ish shoqëria UK Librazhd ka në administrim 4,757 lidhje me ujin nga të cilat 4,700 lidhje faturohen me matje dhe pjesa tjetër aforfe. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve, prezenca e lidhjeve të paligjshme është e evidentë dhe shkakton humbje që përkon me rreth 7 % të prodhimit vjetor.

Shoqëria shpesh herë ka paraqitur vështirësi në përgatitjen e bilancit e ujit, nevoja për trajnim mbi “Humbjet dhe menaxhimin e tyre” është e domosdoshme.

Në Tabelën 8 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Librazhd mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit.

Tabela 8. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Librazhd – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,115,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	542,147	48.62%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	3,000	0.27%
Faturimi Total	545,147	48.89%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	10,000	0.90%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	30,000	2.69%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	47,178	4.23%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	74,660	6.70%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	151,838	13.62%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	90,000	8.07%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	43,000	3.86%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	31,060	2.79%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	229,461	20.58%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	4,494	0.40%
Humbjet Reale (Teknike)	408,015	36.59%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	559,853	50.21%
UJI PA TË ARDHURA	569,853	51.11%

Komente:

- UPA rezulton në nivelin 51.11% të prodhimit vjetor dhe konsiderohet në nivele të larta e të papranueshme.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara më matje (DMA), formati i bilancit të ujit shpesh herë është plotësuar nga stafi me mjaft vështirësi. Shihet si domosdoshmëri nevoja për trajnim të stafit mbi humbjet e ujit dhe monitorimin e tyre.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar, vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, e bën të pabesueshme vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht të treguesit UPA.
- Humbjet teknike në nivelin 36.59 % të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta, si ato prej 20.58 % në rrjetin shpërndarës edhe në linjën e transmetimit prej 8,07%
- Humbjet administrative (13.62 %) përbëhen nga lidhjet e paligjshme në transmetim (2.69 %) e në shpërndarje (4.23 %)..
- Konsumi total (48.89 %) faturohet me matje në nivelin 99.44 % ndërsa 95.1 % e konsumatorëve janë të pajisur më aparate ujëmatës individuale.

Rekomandime:

- Duke pasur parasysh që prodhimi vlerësohet (100 %), nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e matësve në prodhim, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Duke pasur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e veprimeve për zvogëlimin e tyre.

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Peqin dhe Librazhd ofron shërbimin e mbulimit me ujë për 158,201 banorë ose **67.4 %** të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 70,395 lidhje, nga të cilat 59,320 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **21,588,400 m³** rezulton **i vlerësuar rreth 100 % e prodhimit** (vetëm 33,600 m³ raportohet i matur), nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura rezultoi në nivelin **65.31 %** të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm **7,488,367 m³ ujë** ose **34.69 %** të prodhimit.

Tabela 9 paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Elbasan.

Tabela 9. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	21,588,400	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	6,404,377	29.67%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,083,990	5.02%
Faturimi Total	7,488,367	34.69%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	83,751	0.39%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,093,219	5.06%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	3,645,476	16.89%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,722,310	12.61%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	7,461,005	34.56%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	1,272,002	5.89%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	370,252	1.72%

Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	422,940	1.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	4,405,018	20.40%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	75,065	0.35%
Humbjet Reale (Teknike)	6,555,277	30.36%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	14,016,282	64.93%
UJI PA TË ARDHURA	14,100,033	65.31%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 65.31 % të prodhimit vjetor, konsiderohet i lartë dhe që duhet përmirësuar me përparësi.
- “Uji i Prodhuar” i vlerësuar në nivelin 100 % bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit, duke filluar që nga vlera e pasaktësisë në matje prej 12.61 % të prodhimit vjetor dhe të treguesit të UPA.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës (16.89 %) konsiderohen të larta e të papranueshme.
- Humbjet teknike (30.36 %) konsiderohen mjaft të larta prandaj duhen dhënë argumenta të mëtëjshme për justifikimin e tyre, ato shkaktohen në nivelin 20.40 % e prodhimit vetëm në rrjetin shpërndarës.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 84.3 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100 % të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Duke pasur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*

- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100 %, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, me prioritet instalimin e tyre në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Për lidhjet e paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të pasur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikes në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-se. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*